



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 3748/3 Prot.

Tiranë, më 24 03 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3748/1 PROT., DATË 20.02.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. ILIR HILAJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Ilir Hilaj, me nr. nr.1338/20 prot., datë 26.05.2022, nr. 2538 prot., datë 19.09.2022, nr. 2538/1 prot., datë 21.09.2022, nr. 2538/3 prot., datë 06.10.2022, nr. 2729 prot., datë 26.09.2022, nr. 2729/1 prot., datë 17.10.2022, nr. 2729/2 prot., datë 17.10.2022, nr. 2729/3 prot., datë 17.10.2022, nr. 2729/4 prot., datë 21.10.2022 si dhe nr. 2893 prot., datë 11.10.2022, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve S.H., me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, I.B., G.D., A.Gj., O.L., E.A., me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe L.F., me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin nr. 3748/1 prot., datë 20.02.2026, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Ilir Hilaj”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Fier, sipas adresës së deklaruar nga ankuesi Rruga e Pyllit, lagjja "Iliria", Levan, Fier;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

